

Perkthyer ne shqip nga



*Open Society Foundation for
Albania – Soros Foundation*



European Stability Initiative
BERLIN - BRUSSELS - SARAJEVO

Rruga për në Selanik: Kohezioni dhe Ballkani Perëndimor

Berlin, 12 Mars 2003

Në radhët e vendeve të Ballkanit Perëndimor sa vjen e rritet frika se me ribërjen e hartës politike dhe ekonomike të Evropës në vitin 2004 këto vende do të lihen në periferi të Evropës së re të integruar. Ekziston rreziku se vendet e Ballkanit Perëndimor, në vend që të arrijnë të ecin në hap me pjesën tjetër të kontinentit, do të vazhdojnë të mbesin gjithnjë e më mbrapa dhe kësioj qëllimi i integritimit – së bashku me premtimin për stabilizimin e rajonit që rrjedh prej tij – do të bëhen gjithnjë e më të largët.¹

Ky punim diskutues paraqet një skenar alternativ. Si pikënisje për një qasje të re evropiane mund të shërbejë reflektimi për nevojat e Ballkanit Perëndimor të parashtruara në një dokument pune të presidencës së tanishme greke të BE-së në Janar 2003:

“Me lëvizjen graduale të vendeve të Ballkanit Perëndimor nga faza e stabilizimit dhe rindërtimit drejt fazës tjetër të bashkimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, gjithnjë e më shumë ndihet nevoja për politika që sjellin kohezion ekonomik dhe social si në nivelet kombëtare ashtu edhe në ato rajonale, vecanërisht nëse marrim parasysh nivelin e lartë të papunësisë si dhe përmasat sociale dhe rajonale të problemeve etnike që ekzistojnë në shumicën e këtyre vendeve. Presidenca greke synon të nxis një proces të menduarit për mundësinë e integritimit të qëllimit të *kohezionit social dhe ekonomik* në politikat e BE-së për rajonin, si edhe për mënyrat dhe mjetet, përfshirë edhe ato financiare, të nxitjes së kohezionit nëpërmjet *Procesit të Stabilizimit dhe Asocimit*.”²


Ky punim diskutues analizon mënyrat dhe mjetet e mundshme për një politikë të tillë.³ Këtu pranohet fakti se vendet e Ballkanit sot përballesh me kërcënime të dryshme dhe mundësi të

¹ Ky rrezik përshkruhet në kumtesën ESI *Ballkani Perëndimor 2004 – Asistencë, Kohezion dhe Kufijtë e Rinj të Evropës*, 3 Nëntor 2002. Ky kumtesë është në vazhden e **Konferencës Ëilton Park Tetor 2002**, e cila u mbështet nga *Ministria Britanike për Punët e Jashtme dhe të Komonuelthit* dhe nga *Qeveria e Norvegjisë*. Veprimtaritë e gjera të ESI në fillim të vitit 2003 u mbështetën edhe nga *Instituti për Shoqërinë e Hapur*.

² Ministria e Jashtme Greke, *Dokument Pune: Prioritetet e Presidencës Greke për Ballkanin Perëndimor*, ëëë.eu2003.gr/en/articles.

³ Kjo kumtesë vjen pas një numër prezantimesh të bëra nga ESI dhe që rrodhën nga Konferenca Ëilton Park Tetor 2002 që u përqëndrua në çështjen e një politike të re evropiane kundrejt Ballkanit. Në dhjetor 2002

reja që dallojnë shumë nga ato të para tri viteve. Po ashtu, ky punim diskutues shënon faktin se instrumentet e politikës evropiane nuk u janë përshtatur ende kushteve të sapokrijuara për të patur mundësi të ballafaqohen me këto sfida të reja. Gjithnjë e më shumë ndihet nevoja për strategji të reja që do të nxisin reformat strukturore në të gjithë rajonin, gjë që është esenciale për të kapërcyer më shumë se dy dekada të rënies së thellë ekonomike. Bashkësia Evropiane, nëpërmjet Komisionit Evropian, duhet të forcojë kapacitetet e saj për të prodhuar reforma serioze, si reduktimi i shpenzimeve të administratës publike, likuidimi i firmave që punojnë me humbje dhe fillimi i ri-trajnitimit të punëtorëve të hedhur në rrugë nga shkatërrimi i komplekseve të vjetra industriale të rajonit.



Rumania dhe Bullgaria: popullsia 30.7 milionë
Ballkani Perëndimor: popullsia 24.7 milionë

drejtori i ESI-t Gerald Knaus u ftua të prezantonte analizën e ESI-t para ekipit të Komisionit Evropian për Ballkanin Perëndimor në një seancë “brainstorming” në Bruksel, si edhe përpara Këshillit të Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor (COËEB) me ftesë të Presidencës Daneze (Bruksel). Më 1 shkurt 2003 ESI e paraqiti analizën e vet në një “brainstorm” të mbajtur në Hotelin Dorin të Brukselit që kryesohej nga ish Presidenti danez Martti Ahtisaari dhe Kryetari i Institutit të Shoqërisë së Hapur, George Soros. Brainstormi që u ndoq nga politikëbërës dhe ekspertë nga e gjithë Europa, në mes tyre edhe Zëvendës Kryeministri i Maqedonisë dhe Ministri i Financave të Malit të Zi, kishte për objekt diskutimin e raportit të ESI-t për muajin nëntor. Këto ide ESI ua ka bërë të ditura edhe qeveritarëve boshnjakë, kroatë dhe Serb si edhe Zyrës së Përfaqësuesit të Lartë (Sarajevë) dhe UNMIK-ut (Kosovë). Këto aktivitete vijuan me një tjetër prezantim të ESI-t përpara COËEB në Bruksel me ftesë të Presidencës Greke në fillim të Marsit dhe nga prezantime të shumta në takimin rajonal të organizuar nga Presidencia Maqedonase më 16 Mars dhe, më tej, në një Seancë Dëgjimore Publike të Komitetit të Parlamentit Evropian për Çështjet e Jashtme, të Drejtat e Njeriut, Sigurinë e Përgjithshme dhe Politikën e Mbrojtjes mbajtur në Bruksel më 18 mars 2003. PËR MË SHUMË INFORMATA RRETH FUSHATËS 2004 KONTAKTONI ESI Berlin, tel: +49 30 532 14455 apo Gerald Knaus, mob: +49 173 6197797.

Kalimi në një politikë të kohezionit evropian për Ballkanin Perëndimor nuk është domosdoshmërisht një sipërmarrje e shtrenjtë. Në vitin 2006, Bashkimi Evropian premtonte se do të shpenzojë 1.432 miliardë euro për të ndihmuar Rumaninë dhe Bullgarinë për t'u antarësuar në BE. Kjo shumë e të hollash është sa 2.6 për qind e GDP-së së dy vendeve të marra së bashku. Momentalisht, Bashkimi Evropian nuk planifikon të japë më shumë se 500 milionë euro për vendet e Ballkanit Perëndimor – që është sa 1 për qind e GDP-së së gjithë Ballkanit Perëndimor. Ngushtimi i hendekut midis vendeve të reja antare, shteteve kandidatë të Bullgarisë dhe Rumanisë, dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor që ndodhen në procesin e stabilizimit dhe bashkimit, nuk do të kërkonte shtesa të tilla të konsiderueshme në resurset e BE sa që të tejkalonin buxhetet e tanishme të parashikuara për Programin CARDS (Strategjia për zhvillim, rindërtim dhe asistencë drejtuar komunitetit) dhe ato që janë vënë në dispozicion të procesit të para-antarësimit gjatë antarësimit të 10 antarëve të rinj në 2004.

Sfida e vërtetë është forcimi i ndikimit të ndihmës evropiane për Ballkanin Perëndimor duke hartuar strategji të reja asistence që rrjedhin nga mësimet dhe teknikat e *politikës evropiane të zhvillimit rajonal*. Administratat publike në të gjithë rajonin, të ngulitura në traditën e politikave autoritare ku politika diktohet nga strukturat më të larta politike drejtë strukturave më të ulëta, duhet të mësojnë teknikat e reja të nxitjes dhe përkrahjes së zhvillimit (ekonomik, politik dhe kulturor) në kushtet e tregut të lirë. Këto administrata duhet të stimulohen për të mobilizuar ato burimet e pakta publike që kanë, që të përkrahin zhvillimin e vendit të tyre. Këto administrata duhet gjithashtu të bëjnë instalimin e sistemeve statistikore bashkëkohore në funksion të hartimit të politikave si edhe duhet të vendosin raporte të reja midis pushteteve në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal. Pikërisht këto janë llojet e problemeve që qasen nga ndihma evropiane për zhvillimin rajonal. Në dhjetëvjeçarët e fundit, Komisioni Evropian ka punuar me rajone të Bashkimit Evropian që kanë qenë periferike në pikëpamje ekonomike dhe më pas edhe me vendet kandidatë për antarësim në BE, për t'i ndihmuar gjatë ballafaqimit me këto sfida. Instrumentet dhe teknikat e zhvilluara ndihmëse janë shumë të përshtatshme edhe për vendet e Ballkanit Perëndimor.

Thelbi i këtij punimi diskutues është që në Samitin e Selanikut të Qershorit të vitit 2003, Bashkimi Evropian të përfshijë zyrtarisht *kohezionin* si parim udhërrëfyes në politikat e BE-së për rajonin duke e zgjëruar Procesin e Stabilizim-Asocimit me forma të reja të ndihmës në fazën e para-antarësimit. Kjo do të ishte edhe një sinjal i fortë për vendet e rajonit se BE-ja është serioze në ndihmën që u jep atyre për të mbërritur cakun evropian.

Përdorimet e politikës rajonale

Logjika e politikave rajonale ka të bëjë me faktin se gjeografia ekonomike dhe vecantitë historike kanë pasojë të mëdha në mënyrat e zhvillimit. Ka të bëjë gjithashtu edhe me faktin tjetër se *shkaqet strukturore* të prapambetjes janë të tilla që mund të përcaktojnë fatet e zonave të tëra, qofshin ato qendra të vjetra industriale apo zona rurale periferike. Po të mbajmë parasysh shtrirjen që kanë në Ballkanin Perëndimor probleme të tilla strukturore ekonomike, përvojat e fitura në procesin e zbatimit të politikave rajonale gjetkë në Evropë janë drejtëpërdrejt të vlefshme.

Politika rajonale (e quajtur edhe *politika e kohezionit* apo *politika strukturore*) dhe institucionet që nevojiten për zbatimin e saj u hartuan së pari brenda shteteve antare të BE-së në nivel kombëtar, duke fituar më vonë rol qëndror në caqet politike të BE-së. Rrethanat historike që krijuan nevojën për njohjen e rëndësisë së politikave rajonale kombëtare, rrjedhin

nga vetë kriza ekonomike dhe shoqërore e shoqërisë më të vjetër industriale të Evropës, Britanisë së Madhe.

Pas Depresionit të Madh të viteve 1929-1932, u vu re se disa nga rajonet e Britanisë së Madhe u rëkëmbën relativisht shpejt, kurse të tjerat jo. Më të goditurat ishin sektoret dhe zonat më të vjetra industriale, si: industria e ndërtimit të anijeve në Cludeside; industrinë e qymyrit, hekurit, celikut dhe industria e rëndë në Anglinë Veri-Perëndimore; industrinë e ndryshme inxhinjrike dhe industria e pambukut në Lancashire; eksportet e qymyrit, hekurit dhe celikut në Uellsin Jugor.⁴ Nisur nga situata, qeveria britaneze krijoi një *Komision Mbretëror për Shpërndarjen Gjeografike të Popullsisë Industriale* (Komisioni Barlow) për të analizuar gjendjen dhe për të rekomanduar masat që duheshin marrë në kuadrin e politikave publike.

Komisioni Barlow zbuloi atë që e quajti “efekti strukturor”, term që shpjegonte lidhjen e drejtpërdrejtë në mes të rajoneve me të zhvilluara britaneze me strukturat më të përshtatshme industriale. Në zonat që ishin ende në depresion, industrinë po degjeneroheshin me shpejtësi dhe po tërhiqnin në humnerë gjithë ekonominë lokale, deri në atë masë sa “do të duheshin përpjekje mbinjerëzore thjesht për t’u mbajtur ekonominë në të njëjtin nivel.”⁵ Tashmë kishin lindur forca të reja, objektive dhe të fuqishme që i largonin investimet dhe ndërmarrjet e reja nga qendrat e vjetra industriale, të cilat ishin kryesisht të izoluara nga qendrat kryesore tregëtare. Në këtë mënyrë, grupe të mëdha të popullsisë mbeteshin pa shpresë dhe përqëndrime të mëdha të kapitalit shoqëror pa asnjë përdorim. Nëse do të mirreshin masat e duhura ekonomike, në këto kushte, ato do t’i krijonin humbje të mëdha shoqërisë britaneze të koncentruar në këto zona. Këto humbje do të shfaqeshin në formë të niveleve të larta të papunësisë strukturore. Sic thoshte Peter Hall, “Komisioni Barlow nuk shihte kurrfarë mundësie që faktorët ekonomik vetvetiu të fillonin të merrnin drejtim pozitiv.”⁶ Pranimi i shkaqeve strukturore të prapambetjes rajonale u bë baza intelektuale në të cilën mbështeteshin politikat rajonale të Britanisë së Madhe pas luftës. Në fakt, ajo që nxiti krijimin e *Fondit Evropian për Zhvillimin Rajonal* në nivel evropian, ishte vetë antarësimi i Britanisë së Madhe në Komunitetin Evropian, në vitin 1973. Ky Fond u krijua pikërisht për t’iu përgjigjur problemit të rajoneve që po degradoheshin, duke krijuar parakushtet për lindjen e burimeve të reja dhe vitale për zhvillim ekonomik.

Politikat Evropiane për zhvillim rajonal, që shfaqeshin gjithnjë e më shumë në atë kohë, përfituan shumë edhe nga eksperiencia franceze. Në historinë e Francës së pas luftës u krijua një institucion qendror planifikimi (*Commissariat general au plan*), i cili nëpërmjet degëve rajonale për koordinimin e agjencioneve rajonale dhe administrimin e fondeve për zhvillim rajonal, kishte për detyrë të nxiste shpërndarjen territoriale të vendeve të punës në sektorin e prodhimit dhe shërbimeve, si edhe krijimin e vendeve jo-bujqësore të punës në zonat rurale.

Parimi i zhvillimit të balancuar ekonomik është i vjetër sa vetë Komuniteti Ekonomik Evropian, që zë fill me Traktatin e Romës (1957). Por politikat e zhvillimit rajonal fituan një rëndësi akoma më të madhe gjatë viteve të ‘80-a, kur edhe morri hov zhvillimi i një tregu (të vetëm) të përbashkët evropian dhe integrimi monetar, si edhe zhvillimi i reformave që ndërmorri Komisioni i kryesuar nga Jacques Delors. Caqet kryesore të Komisionit Delors ishin: eliminimi i pengesave që kishin mbetur drejt një tregu të përbashkët evropian dhe përgatitjet për një valutë të vetme evropiane.

⁴ Peter Hall, *Urban and Regional Planning*, 4th ed., p. 56.

⁵ Ibid., p. 60.

⁶ Ibid.

Në të njëjtën kohë, filloi të pranohej edhe fakti se heqja e barrierave tregtare dhe forcimi i stabilitetit valutor do të kishte efekte negative mbi rajonet ekonomikisht periferike. Në një raport shumë të njohur të botuar në vitin 1987, ekonomisti Tommaso Padua-Schioppa, sot anëtar i Bordit Ekzekutiv të Bankës Qendrore Evropiane, argumentonte se liberalizimi i tregut do të përkeqësonte jo-balancin ekzistues midis rajoneve, gje që do të shtyente drejte marrjes se masave shoqëruese që do të mbështetnin perparimin e rajoneve më të dobëta. Sot pranohet nga të gjithë ata që merren me politikën rajonale në Komisionin Evropian, se “integrimi gjithnjë e më i madh ekonomik nuk con domosdoshmrisht në zvogëlimin e dallimeve rajonale dhe se, të paktën në fillim, edhe mund t’i thellojë ato.”⁷

Në fund të viteve të ‘80-a, politika rajonale evropiane u zyrtarizua dhe morri formën e një angazhimi zyrtar drejtë kohezionit, që edhe u përfshi në Traktatin e Mاستrihtit të vitit 1991 si një nga tri shtyllat kryesore të Bashkimit të ri Evropian:

“Duke synuar nxitjen e zhvillimit të gjithanshëm dhe të harmonizuar, Komuniteti do të hartojë dhe do të zbatojë politika që cojnë në forcimin e kohezionit të tij ekonomik dhe social ...Caku i Komunitetit do të jete zvogëlimi i dallimeve ndërmjet niveleve të zhvillimit të rajoneve të ndryshme.” (Neni 158)

Ray Mac Sharry, ish Ministër i Financave në Irlandë, që është një nga vendet që ka përfutuar në mënyrë të dukshme nga politika rajonale evropiane, ka shkruar se pa vendosjen e drejtëpeshimit të duhur ndërmjet efikasitetit (tregut të perbashket), stabilitetit (monedhes se perbashket) dhe solidaritetit (fondeve strukturore dhe ato të kohezionit), “komuniteti vështirë se do të mund t’u bënte ballë tensioneve sociale që lindën si pasojë e krijimit kaq të shpejtë të një tregu dhe një valute të (vetme) perbashket në Evropë.”⁸

Irlanda vazhdon të mbetet modeli më i suksesshëm i politikës evropiane të kohezionit. Sic kanë vënë në dukje Mac Sharry dhe ish kreu i Agjencionit Irlandez për Zhvillim Industrial, Padraic Èhite, “nëse historia ekonomike e Irlandës do të kishte perfunduar në vitin 1986, gjykimi i rezultateve ekonomike të vendit që nga koha e Pavarësisë do të kishte perfunduar me një ndëshkim të vërtetë ... Eshte e vështirë të mos pranohet konkludimi se gjate shekullit të njëzetë, Irlanda ka patur aktivitet shumë të dobët ekonomik në krahasim me vendet tjera të Evropës Perëndimore, apo ndoshta edhe në krahasim me gjithë Evropën.”⁹ Mirëpo, Irlanda ka arritur të rris GDP-në e saj nga 2/3 e mesatares së BE-se kur u antarësua më 1970 në 118 për qind në ditët e sotme. Ky zhvillim i shpejtë është nxitur pjesërisht nga rritja e menjëhershme e investimeve të huaja që “morën hov nga cdo artikull që shpenzohej në kuader të transfereve financiare, që në fund të viteve të ‘80-a u quajtën fondet strukturore dhe fondet e kohezionit të Bashkimit Evropian.”¹⁰ Për shembull, shpenzimet e trajnimit të stafit irlandez për kompanite e huaja që investonin në Irlandë, mbulohej teresisht nga Agjencioni Irlandez për Zhvillim i cili pastaj i mbulonte 75% të ketyre shpenzimeve me të holla nga Komisioni Evropian.¹¹ Sic deklarohet Mac Sharry, Bashkimi Evropian ka pasur një rol parësor në këtë proces të mbërritjes së standardeve të BE-së. Hapi i madh ekonomik që ka bërë vendi që nga viti 1989 “ka në themel 17 miliardë paund që ka marrë në përgjithësi nga BE-ja që nga 1989 – më shumë se gjysma e të cilave në kuadrin e Fondeve Strukturore dhe të Kohezionit.”¹²

⁷ Tommaso Padoa-Schioppa, *Efficiency, Stability and Equity: A Strategy for the Evolution of the Economic System of the European Community*, Oxford University Press, London 1987.

⁸ Ray Mac Sharry, Padraic Èhite, *The Making of the Celtic Tiger – the Inside Story of Ireland’s Boom Economy*, 2000, p. 168.

⁹ Ibid., p. 40.

¹⁰ Ibid., p. 179.

¹¹ Ibid., p. 181.

¹² Ibid., p. 154.

Ndikimi i evropianizimit ka qenë shumë i dukshëm edhe në rastin e vendeve mesdhetare. Në Spanjë, Greqi dhe Portugali, GDP-ja për person u rrit nga 68 për qind e mesatares së BE-së në 79 për qind të saj, në periudhën midis viteve 1989 dhe 1999, si rezultat i përfitimeve që patën këto vende njëherazi nga hyrja në një treg të madh të përbashkët, nga disiplina fiskale që impononte progresi drejt një monedhe të vetme dhe nga hyrjet e mëdha të fondeve në kuadrin e ndihmave financiare strukturore që jepte BE-ja.

Plani Marshall, që pati sukses të paparë në rimëkëmbjen e Evropës nga plagët e Luftës së Dytë Botërore, pranohet si shembulli më i suksesshëm i ndihmave strukturore ekonomike që i shërbeu stabilitetit afatgjatë dhe demokratizimit. Shtetet e Bashkuara akorduan burime që përlllogaritëshin në 2 për qind të GDP-së së vendeve përfituese në vitet 1948-1951, me një total kumulativ prej 8 për qind. Në të njëjtën kohë, transferet kumulative nga fondet strukturore dhe të kohezionit të BE-së për Spanjën, në periudhën 1986-1997, arrinin në 9.5 për qind të GDP-së së saj.¹³ Në rastin e Portugalisë dhe të Greqisë, shifrat ishin akoma më të larta.

Por, Bashkimi Evropian ka qenë më pak efektiv në marketingun e ndikimit të politikave të veta drejtë zhvillimit rajonal, që demonstrojnë *fuqinë e butë* evropiane në zhvillimin ekonomik, social dhe institucional të Spanjës, Portugalisë dhe Greqisë. Me zgjerimin e BE-së, instrumentet e integritit (tregu i përbashkët, konvergimi makroekonomik dhe politikat e kohezionit) gjejnë përdorim në një kategori vendesh me një shkallë akoma më të lartë diversiteti.

Politika rajonale e BE-së ka për qëllim të përmirësojë performancën afatgjatë të vendeve përfituese për t'u zhvilluar. Ndihma e BE-së përqëndrohet në anën e ofertës ku pjesa më e madhe e ndërhyrjeve drejtohet kah infrastruktura dhe trajnimi profesional. Fondet strukturore kanë për qëllim të krijojnë "sinergji dhe forca centrifugale (*spin-offs*) pozitive me anë të një numri masash të ko-ordinuara në drejtim të përmirësimit të kapitalit njerëzor, krijimit të infrastrukturave dhe nxitjes së veprimtarive prodhuese."¹⁴ Këto fonde duhet të nxisin investimet, dhe jo konsumimin, në kuadrin e ekonomive pritëse. Supozohet se grantet e BE-së mund të kenë ndikim pozitiv vetëm në rastet kur plotësojnë, dhe jo kur zënë vendin e shpenzimeve që duhet të bëjë vendi.

Për të pasur rezultate pozitive, BE-ja ka përcaktuar një numër parimesh operationale që udhëheqin ndërhyrjet e tij. Këto parime ndër tjerash përfshijnë:

- **Komplementaritetin:** Fondet e BE-së u shtohen investimeve publike me burimet e vetë vendit për të shmangur zëvendësimin e tyre. Bashkëfinancimi nga ana e vendit përfitues është kusht i detyrueshëm;
- **Hartimin e planeve të zhvillimit:** Të gjitha projektet e mbështetura nga BE-ja duhet të jenë pjesë e programeve afatgjata të zhvillimit që harton rajoni/vendi, me qëllim që të sigurohet një rrezatim sa më i gjerë i efekteve të tyre. Procedurat e BE-së kërkojnë hartimin e një game të tërë planesh të cilat garantojnë përputhjen e projekteve me nevojat e komunitetit dhe me politikën e përgjithshme ekonomike të vendit në fjalë;
- **Partneritetin:** Për t'u siguruar se programet pasqyrojnë sa më mirë interesat e komuniteteve përfituese, BE-ja kërkon një partneritet të ngushtë midis Komisionit dhe

¹³ Horst Reichenbach, *The Implications of Cohesion Policy for the Community's budget*, In Jorgen Mortensen ed., *Improving Economic and Social Cohesion in the European Community*, CEPS 1994.

¹⁴ Goybet dhe Bertoldi, 1994, p. 229.

autoriteteve rajonale dhe qendrore të cilat duhat të punojnë së bashku për hartimin, zbatimin, mbikqyrjen dhe vlerësimin e programeve operacionale. Kjo pasqyron parimin e funksionimit si filiale/degëzime që zbatohet nga BE-ja dhe që ka kontribuar drejtpërdrejt në forcimin e pushteteve rajonale në një numër vendesh anëtare.¹⁵

Momentalisht, këto strategji të ndihmave po shtrihen jashtë Bashkimit Evropian tek vendet kandidatë. Sic vinte në dukje në vitin 2001 Drejtoria për Politikën Rajonale, “prania e vendeve të reja antare që përbëhen thuajse tërësisht nga rajone që kanë nevojë të përgjithshme për mbështetje për zhvillimin e tyre ekonomik do të kërkojë rifokusimin masiv të përpjekjes së deritanishme në mënyrë që të arrihen standardet e kërkuara brenda një afati të arsyeshëm.”¹⁶ Për vitin 2006, BE-ja ka planifikuar 9.7 miliardë euro për ndërhyrje strukturore në vendet e reja antare.

Krahasimi i kësaj eksperience me mënyrën sesi janë zbatuar programet e rindërtimit në Ballkanin Perëndimor këto vitet e fundit, ku projektet rrallë kanë qenë të mbështetura në strategji të shëndosha zhvillimi, do të shërbente për të nxjerrë mësim të vlerfshme. Si pasojë, ndihmat kanë qenë të orientuar keq dhe qeveritë përfituese vazhdojnë të mos kenë kapacitete dhe resurse për të mbështetur rritjen e sektorit privat dhe, madje, as për mirëmbajtjen e pasurive publike. Me përfundimin e programit të rindërtimit po zvogëlohen edhe investimet kapitale.

Parimet dhe strategjitë e hartuara në kuadrin e politikave evropiane të kohezionit, duke bërë përshtatjet e duhura me kushtet e secilit vend, janë të gatshme për t’u përdorur edhe në kuadrin e ndihmave strukturore të BE-së për vendet e Ballkanit Perëndimor. Për të nxitur disiplinën fiskale dhe ndërmarrjen e politikave të shëndosha makroekonomike, mund të vendosen kushte. Fondet e kohezionit u përdorën për të garantuar hartimin e programeve të konvergimit ekonomik nga të gjitha vendet antare të BE në përputhje me Traktatin e Mastroitit.¹⁷ Në rastin e Ballkanit Perëndimor, kondicionaliteti mund të përdoret për të nxitur zbatimin e politikave të përgjegjshme ekonomike në mbështetje të zhvillimit afatgjatë dhe të politikave të konvergimit me BE-së. Por kondicionaliteti mund të përdoret edhe për të nxitur marrjen e masave që synojnë përmirësimin e performancës në anën e ofertës, për shembull duke zvogëluar subvencionet shtetërore për ndërmarrjet ish-shtetërore dhe duke shtrënguar masat buxhetore për firmat që punojnë me humbje. Brenda një kuadri të përshtatshëm institucional dhe financiar, mund të rriten në mënyrë spektakulare opsionet që nxisin përmirësimin e menaxhimit ekonomik në rajon.

Problemet strukturore në Ballkanin Perëndimor

Ballkani Perëndimor është një rajon tejet i larmishëm nga këndvështrimin ekonomik, social dhe politik. Por rajoni në tërësi ka të përbashkëta problemet e rënda strukturore të zhvillimit: gjurmët e dukshme të një gjysëm shekulli të sistemit socialist (jugosllav) që u pasua nga humbja e një dekade të tërë në luftë, sanksione dhe zhvendosje të popullsisë në të katër anët e rajonit. Dy problemet më të dukshme janë shkalla e lartë e c’industrializimit dhe problemi i vjetër i prapambetjes së thellë rurale.

¹⁵ Herve & Holtzmann, *Fiscal Transfers and Economic Convergence in the EU: An Analysis of Absorption Problems and an Evaluation of the Literature* (Nomos Verlagsgesellschaft, Baden-Baden, 1998), p. 32-3.

¹⁶ Komisioni Europian, *Second Report on Economic and Social Cohesion*, january 2001.

¹⁷ Horst Reichenbach, *The Implications of Cohesion Policy for the Community’s budget*, In Jorgen Mortensen ed., *Improving Economic and Social Cohesion in the European Community*, CEPS 1994.

Vazhdimi i procesit të c'industrializimit ka cuar shumë fusha drejtë një rënie katastrofike të punësimit, që akoma nuk ka mundur të gjejë shprehje në statistikat zyrtare. Shtetet që dolën nga ish Jugosllavia trashëguan një numër firmash industriale që u ngritën gjatë boom-it të investimeve në vitet 1970 kur kapitali i huaj sigurohej me lehtësi. Regjimi socialist kishte si politikë kryesore sociale hapjen e vendeve të reja të punës në ndërmarrjet me pronësi publike. Për shembull, në Bosnjë dhe Hercegovinë, gjatë gjithë viteve 1970, në ndërmarrjet industriale hapeshin me ritme të jashtëzakonshme 2500 vende të reja pune në muaj. Shpërndarja gjeografike e industrisë bëhej jo në bazë të kriterëve ekonomike, por në bazë kriteresh sociale edhe pse një pjesë e madhe e investimeve rezultonin inefficente në pikëpamje ekonomike dhe teknike. Ndërmarrjet industriale që lindën nuk arrinin të gjeneronin fitime dhe në fillim të viteve 1980 u pa qartazi se po konsumonin vetveten.

Industritë e vjetra po shkatërrohen me shpejtësi në të gjithë rajonin. Është e pamundur të gjenden investitorë të besueshëm për privatizimin e kompanive të mëdha të ngarkuara me borxhe, fuqi të tepërt punëtore dhe teknologji të vjetëruar. Shumë syresh i kanë mbyllur dyert, të tjera vazhdojnë prodhimin duke akumuluar humbje të mëdha që, në fund të fundit, do t'i rëndojnë buxhetit publik. Mbijetesa e rajoneve të tëra sot kërcënohet nga shembja e këtyre ndërmarrjeve. C'industrializimi krijon probleme masive strukturore për ekonominë e vendit që fillojnë me mos-shfrytëzimin e kapaciteteve industriale, me infrastrukturën që për komunitetet post-industriale rezulton e kushtueshme për t'u mbajtur, fuqinë punëtore që nuk zotëron aftësitë që kërkohen nga sektori i ri privat e që mbarojnë me qendra të tëra të populluara që nuk e kanë më justifikimin ekonomik të ekzistencës së tyre.

Po aq i rëndë është edhe problemi i ekzistencës së zonave të mëdha të lëna në prapambetje të thellë rurale. Kjo është pasojë e dekadave të tëra të ndalimit të bujqësisë private dhe lënies në harresë të fshatit nga sistemi socialist. Sipas një historiani të sferës ekonomike, në Jugosllavinë socialiste “prodhimi për cdo bujk të aftë për punë deri në vitin 1963 nuk u ngrit mbi nivelet e vitit 1939 (me përjashtim të ndonjë rasti të përkohshëm). Në vitet 1976-8, rendimenti i punës në fermat jugosllave ishte vetëm sa 10 për qind e rendimentit të Britanisë, 16 për qind të Francës dhe afërsisht po aq të Pakistanit. Sektori i madh kooperativist kurrë nuk arriti të shkëputej nga nivelet e zanafillës së vetëushqyerjes.”¹⁸

Sot, në të gjithë Bosnjën, Maqedoninë, Kosovën dhe në disa pjesë të Serbisë, zhdukja e punësimit industrial ka bërë që njerëzit e nxjerrë jashtë ekonomisë formale t'i kthehen bujqësisë për qëllime mbijetese. Bujqit e vegjël punojnë sipërfaqet e tyre të vogla me mjete të pakta. Duke qenë se mjetet bujqësore janë ato të 50 viteve më parë, ata prodhojnë një tepicë të vogël për shitje nga e cila nuk arrijnë të sigurojnë investimet e nevojshme për rritjen e rendimentit. Kapaciteti i vetë sektorit bujqësor për t'i nxjerrë këto zona rurale nga varfëria është i kufizuar. Vendet kanë nevojë jo vetëm për investime në bujqësi, por edhe për strategji të reja zhvillimi që mbajnë parasysh karakteristikat e rajoneve rurale. Për momentin, faktorë të tillë që mbizotërojnë në shkallë të lartë si transporti dhe infrastruktura e papërshtatshme, si dhe mungesa e dijeve bashkëkohore në rradhët e popullsisë rurale, tregojnë se zhvillimi i sektorit privat në këto zona vazhdon të jetë tejet i dobët. Në kushtet e mungesës së perspektivës për zhvillim të zonave rurale, opsioni më i mirë për popullsinë fshatare është emigracioni ekonomik masiv.

Këto probleme strukturore binjake sjellin pasoja të mëdha për qeverisjen e rajonit. Qeveritë kanë burime të pamjaftueshme të ardhurash për të mbajtur në këmbë një administratë

¹⁸ Shih: Michael Palaret, dorëshkrim i pabotuar, *The mismanagement of the Yugoslav rural economy, 1945-1990*, p. 31. Palaret i referohet edhe Veselinovit, *Sumrak seljastva*.

moderne të stilit evropian. Një tjetër pasojë e rëndë është se burimet për sigurimin e mbrojtjes sociale të nevojshme për të amortizuar humbjen e vendeve të punës janë shumë të pakta.¹⁹ Më tej, infrastruktura e ngritur për t'u shërbyer nevojave të industrisë socialiste është shumë e kushtueshme dhe nuk mund të mbahet nga komunitetet post industriale, ç'ka po i con asetet publike drejt shkatërrimit të plotë. Në kushtet kur burimet publike janë të pamjaftueshme, një pjesë e madhe e buxhetit shkon për mbajtjen e administratës publike duke lënë shumë pak fonde për shërbimet dhe investimet publike. Kjo krijon një rreth vicioz për zhvillimin: minon ligjshmërinë dhe efektivitetin e institucioneve publike (me pasoja të rrezikshme për shtetet e reja dhe shpesh të brishta) dhe njëkohësisht shkurajon zhvillimin e sektorit privat. Pra, del e qartë nevoja për lloje të ndryshme të asistencës që sjellin mobilizimin e burimeve të brendshme dhe jo aq mbushjen e boshllëkut të shpenzimeve kapitale në vend.

Pikërisht për kapërcimin e këtyre problemeve u krijuan politikat rajonale të Evropës. Po të pranojmë se shumë nga problemet themelore të Ballkanit Perëndimor nuk janë shumë të ndryshme në natyrën e tyre nga ato që janë trajtuar gjatë në Evropë, kjo do të hapte rrugën për nxjerrjen e mësimëve dhe ekspertizave të vyera nga përvoja e gjerë europiane.

Para-antarësimi pa negociata

Deri pak kohë më parë, politika e Bashkimit Evropian ishte thellësisht e ndarë në pikëpamje të qasjes ndaj kontinentit Evropian. Nga njëra anë, për vendet candidate, ka një strategji të qartë për t'i ndihmuar gjatë gjithë procesit të anëtarësimit paralelisht me mbajtjen e negociatave. Ato përfitojnë nga fondet e para-antarësimit që dalin nga një zë i vecantë i buxhetit të BE-së (kapitulli i 7 i programit financiar të BE-së), gëzojnë përkujdesjen e një Drejtorie të posacme për Zgjerimin si edhe vëmendjen gjithnjë në rritje të Drejtorive dhe të institucioneve të tjera të BE.

Në anën tjetër, është "Evropa e gjerë" e cila bën pjesë në të njëjtën kategori me pjesën tjetër të botës në zhvillim. Evropa e gjerë trajtohet nga Drejtoria për Punët e Jashtme dhe fondet për të dalin nga i buxhetit i caktuar për aktivitetin me jashtë (kapitulli 4 i programit financiar të BE-së).

Deri në fund të vitit 2002, sistemi kishte një natyrë të thjeshtë binare: vendet e Evropës ose ishin candidate ne rrugën e antarësimit, ose i kaloheshin Evropës së gjerë. Për Shtetet e Ballkanit Perëndimor, BE-ja kishte marrë një angazhim politik se, në kohën e duhur, do t'u jepej mundësia të dilnin nga Evropa e gjerë dhe të bëheshin candidate për në BE. Por për shumë syresh ky mbetet një imazh i të ardhmes së largët.

Së fundmi, dallimi midis dy kampeve është mjegulluar. Në 1999, Turqia u ngjit në statusin e kandidatit së bashku me Rumaninë dhe Bullgarinë. Ndonëse kaloi në përgjegjësinë e Drejtorisë së Përgjithshme për Zgjerim, fondet vazhdonte t'i merrte nga buxheti për punë të jashtme të BE-së. Në fund të vitit 2002, në Samitin e Kopenhagës u morr vendimi që asistenca e ardhshme për Turqinë të dilte nga buxheti i para-antarësimit (kapitulli 7), edhe pse negociatat për antarësim ende nuk kanë filluar. Turqia trajtohet tani si të ishte candidate e BE-së me të drejta të plota, edhe pse vendimi në i përmbush apo jo kushtet për hapjen e negociatave nuk do të merret deri në fund të vitit 2004. Kjo madje deklarohet edhe në

¹⁹ Në Bosnjë dhe Hercegovinë, për shembull, nga 420,000 njerëz që ishin rgjisituruar si të papunë në vitin 2001, vetëm 4,900 përfitonin pagesën e papunësisë që shpërndahej në baza mujore.

Raportin e vitit 2001 të BE-së për kohezionin, ku vendet e Ballkanit Perëndimor nuk përmenden. Shkurt, pra, tani Turqia përfaqëson një kategori të re: **para-anëtarësim pa negociata**.

Për trajtimin e Turqisë në këtë mënyrë nga ana e Bashkimit European ka argumenta të fortë strategjikë. Kjo mënyrë i jep mundësi BE të anagazhohet më intensivisht në sfidat e zhvillimit të Turqisë, duke futur në lojë burime të reja financiare dhe instrumenta të reja institucionale për të inkurajuar proceset e reformimit të saj të brendshëm pa e lidhur veten në këtë fazë me afate kohore të përcaktuara për antarësimin përfundimtar të Turqisë.

Argumentet janë njësoj të fuqishme dhe strategjike për përfshirjen **në këtë kategori të re të vendeve të Ballkanit Perëndimor: trajtimi i këtyre vendeve si kandidatë për para-antarësim pa detyrimin e hapjes së negociatave për antarësi derisa Komisioni t'i konsiderojë këto vende si të përshtatshme duke u bazuar në meritat e tyre individuale**.

Hapat e cdo shteti në kuadrin e procesit të stabilizimit dhe bashkimit dhe, më pas, në kuadrin e procesit të antarësimin përcaktohen nga rrethanat dhe kapacitetet e secilit. Kjo qasje e diferencuar është element kyç i strategjisë së BE-së në rajon që duhet ruajtur. Në të njëjtën kohë, për shkak të kërcënimit të vazhdueshëm që përbëjnë për stabilitetin e brishtë politik dhe social të rajonit në tërësi, ekziston një interes i fortë i shprehur nga BE-ja për trajtimin në tërësi të problemeve ekonomike strukturore të përbashkëta për të gjithë rajonin. Është, po ashtu, në interes të BE-së të përdorë sa më shpejt që të jetë e mundur të gjithë arsenalin e saj të mjeteve financiare dhe politike në funksion të përballimit të këtyre sfidave, pavarësisht përparimit që bëjnë shtete të vecanta në kuadrin e procesit të stabilizimit dhe asociimit.

Përfshirja në këtë kategori të re të ndërmjetme – statusi i para-anëtarësimin pa negociata – e vendeve të Ballkanit Perëndimor do të ulte një numër tensionesh të pranishme në strategjinë aktuale që ndjek BE-ja në rajon. Pikësëpari dhe më e rëndësishmja është se kjo do të ndihmonte parandalimin e thellimit të prapambetjes së rajonit në raport me qëllimet themelore të zhvillimit të përcaktuara nga integrimi evropian. Vendet e Ballkanit Perëndimor nuk kanë gjasa të bëhen kandidatë të besueshme për antarësim nëse nuk ia dalin të zgjidhin problemet e tyre ekonomike strukturore. Mundësia për të përfituar nga asistenca e para-anëtarësimin kur ende gjenden në Procesin e Stabilizim-Bashkimit do t'i stimulonte ata për të prodhuar mjetet e brendshme për zhvillim rajonal duke ju siguruar në të njëjtën kohë edhe ndihmën teknike dhe financiare të nvojshme për të filluar zgjidhjen e problemeve të tyre ekonomike strukturore.

Së dyti, kjo do të eliminonte rrezikun e krijimit të vijave të reja ndarëse brenda rajonit nga vetë procesi i antarësimin. Së fundi, kërkesën për antarësim e ka paraqitur Kroacia. Me fillimin e negociatave me këtë vend, hendeku midis Kroacisë dhe fqinjëve të saj lindorë do të thellohet duke krijuar tensione të reja në rajon. Por nga ana tjetër, edhe mos shqyrtimi i kërkesës kroate nga frika e ndikimit që mund të ketë mbi vendet e tjera nuk është as kjo një alternativë e shëndoshë po t'i referohemi rregullit të Komisionit European për gjykimin e kërkesave të antarësisë rast pas rasti në baza individuale.

Në fakt, BE-ja duhet të shqetësohet për faktin se strategjia e saj e tanishme mund të sjellë ngutjen e vendeve të tjera të rajonit për të paraqitur kërkesat për antarësim sa më parë që të jetë e mundur nga frika se mos humbin trenin e antarësimin dhe i kalojnë “Evropës së gjerë” ku shanset janë të pakta. Një nxitim i tillë për pranimin zyrtar rrezikon të minojë Procesin e Stabilizimit dhe Bashkimit. Rruga më e mirë për të shmangur një situatë të tillë është futja e formave të ndihmave të para-anëtarësimin në Procesin e Stabilizimit dhe Bashkimit.

Së treti, dhënia e asistencës strukturore përpara procesit zyrtar të anëtarësimit do t'i jepte një shtytje të fortë përpjekjeve të tanishme të BE-së për forcimin e proceseve të reformave dhe përmirësimin e aftësive qeverisëse në rajon. Forca e metodologjisë së asistencës që ka krijuar nga Komisioni Evropian nëpërmjet fondeve të para-anëtarësimit dhe politikave rajoneve qëndron në aftësinë e saj për shpërndarjen e **dividentit të qeverisjes** – d.m.th në dhënien e ndihmës në mënyrë të tillë që të krijojë motivin dhe të ndërtojë kapacitet e qeverive të këtyre vendeve për të vënë në veprim zhvillimin rajonal dhe për të mobilizuar burimet e brendshme nëpërmjet parimit të bashkëfinancimit. Një analizë e kohëve të fundit për transfertat dhe kapacitet thithëse të vendeve vë në dukje “kontributin themelor të ndërhyrjes me anë të Fondit Struktural në përmirësimin e efektivitetit dhe eficensës së administratës publike në Greqi.”²⁰

Selaniku dhe premtimi i kohezionit

Samiti i Selanikut i planifikuar për qërshor të vitit 2003 ofron një mundësi reale për ripërcaktimin e natyrës së angazhimit evropian në Ballkanin Perëndimor. Ky samit duhet të japë një sinjal të fortë se premtimi i evropianizimit të rajonit nuk do të bjerë së bashku me rënien e valës së rradhës për zgjerim.

Selaniku jep rastin që BE-ja të shprehë angazhimin e vet për kohezionin e vendeve të Ballkanit Perëndimor duke shënuar një proces të përdorimit të instrumentave dhe strategjive të reja për të ndihmuar rajonin të arrijë pikën nga ku anëtarësimi në BE duket një mundësi konkrete. Tri piketat që vijojnë mund të shërbejnë si njësi matëse për suksesin e Samitit të Selanikut:

1. Marrja e angazhimit për ta përfshirë kohezionin ndër objektivat e qarta të BE-së në Ballkanin Perëndimor

Kohezioni nuk është cak i BE-së në Europën e gjerë apo në pjesët tjera të botës, por një aspekt specifik i integritetit evropian. Rrjedhimisht, ai kërkon një angazhim më të madh të burimeve dhe një punë më intensive nga institucionet evropiane.

Kohezioni i ofron BE-së një levë të fuqishme për materializimin e ndryshimeve në rajon. Kjo do ta vendoste BE-në në një pozitë më të fortë për të kërkuar respektimin serioz të shtyllave të tjera të politikës evropiane: politika të përgjegjshme fiskale dhe hapjen e tregtisë. Në ditët tona pjesa më e madhe e vendeve të rajonit kanë arritur të ulin inflacionin. Ka nga ato që përdorin euron në tenderat publik apo që kanë ngritur Bordet Valutore. Nga viti në vit, marrëveshjet dypalëshe të Tregtisë së Lirë po zvogëlojnë barrierat e tregtisë në të gjithë rajonin. Duke u angazhuar publikisht për mbështjen e kohezionit në baza rajonale, BE-ja do të fitonte një pozitë të fortë për të kërkuar përpjekje të përbashkëta nga të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor për arritjen e këtyre qëllimeve.

Realisht kjo do të thotë që Ballkani Perëndimor të përfshihet në kategorinë e “para-anëtarësimit pa negociata” sipas modelit të vendimeve që janë marrë kohët e fundit për Turqinë. Më tej, kjo do të tregojë se BE-ja po angazhohet seriozisht për të mos lejuar

²⁰ Yves Herve, Robert Holzmann, *Fiscal Transfers and Economic Convergence in the EU: An Analysis of Absorption Problems and an Evaluation of the Literature*, 1998, p.73. E njëjta analizë nënvizon se, në pikëpamje të shkenës ekonomike akademike, “përgjithësisht mungon kuadri konceptual për një vlerësim të gjithanshëm të çështjes që ka të bëjë me problemet e thithjes së transfertave të mëdha fiskale” (p. 11).

që vendet e Ballkanit Perëndimor të mbesin mbrapa rajonit evropian duke i ndihmuar ato të arrijnë një nivel zhvillimi nga ku anëtarësimi formal kthehet në një mundësi reale.

2. Marrja e vendimit për të zbatuar mësimet që dalin nga politika e kohezionit të BE dhe nga praktika e vendeve candidate edhe në rastin e vendeve të Ballkanit Perëndimor

Në mënyrë që në vazhdim fondet të përdoren më efektivisht, del nevoja të futen në zbatim strategji të reja asistence që shfrytëzojnë përvojat e politikave të kohezionit të zbatuara gjatë në Evropë lidhur me mobilizimin e burimeve të brendshme, krijimin e kapaciteteve qeverisëse dhe nxitjen e hartimit të politikave të zhvillimit rajonal. Do të ishte me vend që Komisioni në Selanik të ndërmerre fillimin e analizës sesi mësimet e nxjerra nga përdorimi i fondeve të kohezionit mund të vlejnë edhe për Ballkanin Perëndimor, përfshirë këtu bashkëfinancimin, kondicionalitetin, planifikimin e zhvillimit rajonal dhe partneritetin midis Komisionit nga njëra anë dhe pushteteve qendrore dhe rajonale nga ana tjetër.

3. Marrja e zotimit për ruajtjen e niveleve të asistencës me qëllim që hendeku aktual midis vendeve candidate si Bullgaria dhe Rumania, dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor të mos thellohet më tej.

Marrja e angazhimit serioz për kohezionin e Ballkanit Perëndimor është një çështje që lidhet më shumë me hartimin e strategjive të reja të asistencës, sesa me gjetjen e burimeve të reja dhe më të mëdha financiare. Por hendeku i madh i fondeve që planifikohen të shpenzohen pas vitit 2004 për Rumaninë në krahasim me Serbinë apo për Bullgarinë në krahasim me Maqedoninë, ngre pyetje serioze lidhur me besueshmërinë e angazhimit të Evropës në rajon. Në mënyrë që angazhimi për nxitjen e kohezionit në Ballkanin Perëndimor të jetë serioz, Bashkimi Europian duhet të stabilizojë nivelet e asistencës dhe t'i inkuadrojë ato brenda një strategjie afatgjate e të besueshme.

Shumat e parave që nevojiten për të arritur këtë nuk janë aq të mëdha sa mendohen. Në të vërtetë, ndihmat e BE-së të planifikuara për Ballkanin Perëndimor në vitin 2006 janë 500 miliardë euro, ose 1 për qind të GDP-së së të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor marrë së bashku. Rritja e këtyre ndihmave në nivelin e 2 për qind të GDP-së së rajonit do të ishte përsëri nën nivelin e ndihmave së BE-së për Bullgarinë dhe Rumaninë. Nga ana tjetër, kjo rritje do të ishte në përputhje me mësimet për kapacitet thithëse të vendeve që Komisioni ka nxjerrë këto dekadat e fundit.

Nga këtu do të rridhte një angazhim i rreth 1 miliardë euro për Ballkanin Perëndimor në 2006, shumë kjo ekuivalente me shifrat e shpenzimeve të BE-së në rajon këto vitet e fundit. Për financimin e politikave të kohezionit në periudhën 2004-2006, Bashkimi Evropian mund të plotësojë buxhetin ekzistues të CARDS me fonde për para-anëtarësimin duke filluar kështu procesin e zhvendosjes së Ballkanit Perëndimor nga linja e 4-të e buxhetit (veprimtaritë me jashtë) në linjën e 7 (ndihmat e para-anëtarësimit).